



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 11

Prishtinë, më 6 qershor 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Behar Selimi, Albulena Haxhiu, Arsim Bajram, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Armend Zemaj, Ardian Gjini dhe Jasmina Zhivkoviq.

Munguan: Mufera Şinik dhe Ibrahim Makolli.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Antigona Bajrami – përkthyesë, Arsim Avdijaj – NDI, Lejla Selimi – OSBE, Artan Canhasi – EULEX, Lumnije Murati – ZPRK, Vlora Marmullakaj – EULEX, Natyra Kasumaj – KDI dhe Fixhrije Dragaj – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.05.2011,
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë tregtare,
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për Akreditim,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndihmë juridike falas,
7. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11. 05. 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 11. 05. 2011 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë tregtare

Kryetari- E paraqiti për shqyrtim raportin me amandamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë tregtare. Kam vërejtje prej atyre teknike deri te ato përmbajtjesore që realisht e dëmtojnë shumë këtë ligj. Amendamentet 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, janë tërësisht të paqarta.

Arsim Bajrami- Theksoi se amendamentet 5 dhe 6 janë në kundërshtim me rregullativën juridike, sepse as në të drejtën civile, penal ose administrative, afatet nuk llogariten me ditë pune.

Armend Zemaj- Ishe i mendimit që zyra ligjore duhet t'i ndihmojë, sepse disa janë komisione te reja dhe me këtë ligji e ka humbur edhe përmbajtjen edhe strukturën me këto amandamente të radhitura. Në vazhdim vlerësoi se amendamentet në këtë formë, me të vërtetë kanë krijuar një konfuzion dhe kjo nuk mund të shkojë në lexim të dytë, kështu do të jetë problem edhe në finalizim dhe në paraqitjen në gazetën zyrtare dhe në nënshkrimin nga Kryetari dhe Presidenti i vendit.

Ardian Gjini- U pajtua me parafolësit që ky raport duhet të kthehet, sepse po shihet se Komisioni nuk ka përvojë dhe ka shpëputje totale mes Qeverisë dhe Komisionit. Komisioni as nuk e ka të qartë se çka po do me këtë ligj, ndoshta kishte me qenë mirë që të jetë ndokush prej zyrës ligjore të ministrisë.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Komisionit funksional t'ia paraqesë këtë*

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë tregtare e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara nuk mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit, sepse:
 - a. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL në Projektligjin e theksuar nuk janë hartuar në pajtim me rregullativën juridike për hartimin e legjislacionit.
 - b. Amendamentet: 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12 janë krejtësisht të paqarta.

c. Amendamentet 5 dhe 6 janë në mospajtim me rregullativën juridike për llogaritjen e afateve, sepse me këtë rregullativë nuk është përcaktuar llogaritja e afateve me ditë pune. Po ashtu në amendamentin 6 afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh për iniciimin e kontestit administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës është në mospajtim me LKA- në.

3. Komisioni për Legjislacion vlerësoi se është e nevojshme që hartimi i amendamenteve në Projektligjin e theksuar të bëhet në pajtim me rregullativën juridike për hartimin e legjislacionit. Amendamentet 5 dhe 6 të harmonizohen me rregullat juridike, që e përcaktojnë llogaritjen e afateve, me Ligjin për konfliktet administrative dhe në pajtim me Rregulloren e Kuvendit t'i procedohen për shqyrtim Komisionit për Legjislacion.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligji nr. 04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për Akreditim

Komisioni diskutoi për raportin me amendamente të Komisionit Funksional dhe u dhanë vërejtje në amendamentin 6 të këtij raporti.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Komisionit Funksional t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për akreditim e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet: 1, 2, 3, 4 dhe 5 mund të procedohen për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
3. Komisioni vlerësoi se amendamenti 6 i Komisionit Funksional është në kundërshtim me teknikat e hartimit të legjislacionit dhe duhet të riformulohet në tërësi në pajtim me Ligjin e Gazetës Zyrtare.
4. Projektligji dhe amendamentet e propozuara, përveç amendamentit 6, mund të procedohen për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve

Kryetari propozoi që për shqyrtimin e këtij P/L të formohet një grup punues, ku në bashkëpunim me ekspertin e angazhuar nga NDI, ta shqyrtojnë dhe Komisionit t'ia paraqesin propozimamendamentet.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, lidhur me këtë çështje, nxori këtë:

PËRFUNDIM

1. Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve në këtë përbërje:

- Haki Demolli – GP i LDK- së, kryesues;
- Behar Selimi - GP i PD-së, anëtar;
- Albulena Haxhiu – GP i VV-së, anëtare.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndihmë juridike falas

Kryetari propozoi që edhe për shqyrtimin e këtij P/L të formohet një grup i punës ku edhe në këtë P/L është i angazhuar i njëjti ekspert nga NDI, dhe pas shqyrtimit, Komisionit t' ia paraqesin propozimamendamentet.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, lidhur me këtë çështje, nxori këtë:

PËRFUNDIM

1. Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për ndihmë juridike falas në këtë përbërje:

- Behar Selimi – GP i PDK- së, kryesues;
- Halit Krasniqi - GP- PDK- së, anëtar;
- Jasmina Zhivković – GP i SLS-së, anëtare.

7 . Të ndryshme

a. U debatua rreth listës ekzistuese të ekspertëve (databazës) dhe ishte mendim i të gjithëve se kjo listë duhet të plotësohet, sepse disa prej tyre tashmë janë të pensionuar.

Armend Zemaj- U pajtua që lista duhet të plotësohet, por listës së propozimeve t'i bashkëngjitet edhe një CV.

Kryetari- Theksoi se pasi që secili anëtar të sjellë propozimet e mundshme për plotësimin e listës atëherë këtë listë e miratojmë në Komision.

b. U shqyrtua shkresa e Ministrisë së Drejtësisë nr. 01-578 e datës 18.05.201 për pjesëmarrjen e një anëtari nga Komisioni për legjislacion, në Këshillin Konsultativ për Drejtësi.

Komisioni për Legjislacioni vendosi që pjesëmarrës në Këshillin Konsultativ për Drejtësi të jetë z. Arben Gashi – kryetar i Komisionit për legjislacion.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Arben Gashi